



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 06.03.2025

Nr: 239

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE BAZUAR NË DENONCIMIN
NR. 55 ID, DATË 28.02.2025, TË REGJISTRIT TË DENONCIMEVE, TË
QENDRËS “QËNDRESA QYTETARE”**

Sot më datë 06.03.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi mori në shqyrtim paraprak denoncimin me:

KËRKUES: Qendra “Qëndresa Qytetare”

SUBJEKT: **Z. Engjëll Agaçi**
Sekretar i Këshillit të Ministrave

Z. Edi Rama
Kryeministër

OBJEKT: Mosraportim i veprimtarisë publike takim me punonjësit e Bashkisë Tiranë

BAZA LIGJORE: Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator

KONSTATOJ:

Qendra “Qëndresa Qytetare”, më datë 28.02.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, denoncimin e administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 55 ID.

Në këtë denoncim Qendra “Qëndresa Qytetare” parashtron sa vijon: “Më datë 20.02.2025, Qendra “Qëndresa Qytetare” është njoftuar përmes platformave të komunikimit elektronik dhe të mediave të ndryshme se në të njëjtën datë, në orën 16:30 Kryeministri do të zhvillonte një

Data 06.03.2025

Nr: 239
Ora: 12:00



“Për fillimin e procedurës administrative bazuar në denoncimin nr. 55 ID, datë 28.02.2025, të regjistrin të denoncimeve, të Qendrës “Qëndresa Qytetare”

takim ku do të merrnin pjesë të detyruar gjithë administrata e Bashkisë Tiranë. Nga verifikimi ynë, në Ndërfaqen Elektronike të Raportimit të Institucioneve (NRI), rezultoi se kjo veprimtari nuk ishte raportuar në KQZ. Sikundër është bërë publike, takimi i Kryeministrit ka filluar në orën 16:30. Fjala e hapjes është mbajtur nga zj. Anuela Ristani e cila në mënyrë të përmbledhur falënderon Kryeministrin për takimin që në këndvështrimin e saj përbën një sfidë për mbarëvajtjen e punëve publike. Në fjalimin e Kryeministrit janë mbajtur qëndrime të një natyre politike, duke përdorur veprimtarinë publike për të zhvilluar propagandë elektorale. Aktiviteti publik i organizuar në orën 16:30, ndryshe nga sa pretendon KQZ, nuk është raportuar ana e Kryeministrit. Gjithashtu në këtë aktivitet janë bërë ndryshime lidhur me pjesëmarrësit në të.

Punonjësit e Bashkisë Tiranë dhe institucioneve në varësi të saj kanë marrë pjesë në këtë veprimtari gjatë periudhës katër mujore përpara datës së zgjedhjeve dhe zhvillimi i saj nuk është raportuar në KQZ”.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 2, të vendimit nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator, pasi shqyrtova paraprakisht çështjen, vlerësoj se informacioni apo të dhënat e treguara nuk krijojnë një bazë të mjaftueshme për të hetuar administrativisht shkeljet e mundshme.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

V E N D O S:

1. Fillimin e procedurës administrative ndaj:
 - Z. Engjëll Agaçi, Sekretar i Këshillit të Ministrave;
 - Z. Edi Rama, Kryeministër.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Illirjan CELIBASHI